

COVID-19: Mësoni faktet mbi virusin korona 2019

Në dhjetor 2019, zyrtarët e shëndetësisë gjetën se disa njerëz në Wuhan të Kinës po shfaqnin shenja të një sëmundjeje respiratore. Shkencëtarët përcaktuan se ajo shkaktehej nga një virus korona - "i ri" që nuk ishte gjetur më parë. Që prej asaj kohe sëmundja, e cila u emërtua COVID-19, është raportuar në shumë vende të tjera, përfshirë edhe SHBA.

Zyrtarë amerikanë dhe nga vende të tjera po e ndjekin me vëmendje këtë sëmundje. Njerëzit nuk duhet të udhëtojnë në vende ku po transmetohet COVID-19 përveç rasteve kur është e domosdoshme.



Cilat janë simptomat? Si përhapet?

Simptomat e infeksionit nga COVID-19 janë zakonisht një sëmundje respiratore me temperaturë, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje.

Sëmundja mund të sjellë pasoja fatale.

COVID-19 mund të përhapet nga njeriu te njeriu.

Në përgjithësi, viruset korona mund të përhapen nëpërmjet ajrit me anë të kollës dhe teshtimës si dhe nëpërmjet kontaktit të afërt personal, si

për shembull dhënia e dorës, sipas informacionit nga Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve.

Viruset korona mund të përhapen edhe duke prekur një objekt apo sipërfaqe që ka virusin mbi të dhe më pas nëpërmjet prekjes së syve, gojës apo hundës.

Si trajtohet COVID-19?

Për COVID-19 nuk ka vaksinë. Gjithashtu, nuk ka ndonjë trajtim antiviral.

Nëse udhëtoni në një zonë ku ka shpërthyer COVID-19 - ose nëse keni qenë në kontakt të afërt me dikë që mbart sëmundjen - dhe zhvillonit simptoma, duhet të flisni me mjekun tuaj. Sigurohuni që të telefononi para se të shkoni në zyrën e mjekut. Ekipi juaj shëndetësor do t'ju tregojë se çfarë hapash duhet të ndiqni.




Si mund ta mbroj veten nga COVID-19?

Mënyra më e mirë për të parandaluar infektimin nga COVID-19 është që të shmangni ekspozimin ndaj tij. Kjo do të thotë që të qëndroni larg zonave ku ka shpërthyer infeksioni dhe larg njerëzve që janë të infektuar.

Gjithashtu, mund të ndërmerri veprime të përditshme që ndihmojnë në parandalimin e përhapjes së sëmundjeve respiratore:

- Lajini duart rregullisht me sapun dhe ujë për të paktën 20 sekonda. Nëse nuk keni sapun dhe ujë, përdorni dezinfektues për duart që përmban të paktën 60% alkool.
- Shmangni prekjeve e syve, hundës dhe gojës me duar të palara.
- Mos rrini në kontakt të afërt me persona që janë të sëmurë.
- Pastroni dhe dezinfektoni shpesh objektet dhe sipërfaqet e prekura.
- Kur kolliteni apo teshtini, mbulojeni gojën dhe hundën me një shami letre. Shaminë hidheni në kosh dhe më pas lani duart.
- Qëndroni në shtëpi kur jeni sëmurë.



Ku mund të marr më shumë informacion?

CDC-ja dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë ofrojnë informacione për sëmundjen, përfshirë edhe informacion për udhëtimin dhe hollësi të përditësuar të rasteve.

Visitoni faqen e internetit www.cdc.gov dhe www.who.int.

Imazhet nga

Fëmija që teshtin: Foto nga Luisella Planeta Leoni, falënderim

Pixabay

Një grua: Foto nga KatarzynaBialasiewicz, falënderim

iStockphoto

Larja e duarve: Foto nga Lostinbidsr, falënderim iStockphoto

Pastrimi: Foto nga Pascalhelmer, falënderim Pixabay

Përditësuar 2/13/2020

